



## **BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6), dhe në pajtim me nenin 20, paragrafi (2) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 6p.110/ 21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

### **VENDIM për rezervë të detyruar**

#### **I. DISPOZITA TË PERGJITHSHME**

1. Me këtë vendim, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) e rregullon llogaritjen dhe mbajtjen e rezervës së detyruar të bankave dhe filialeve të bankave të huaja (në tekstin e mëtejshëm: Bankat) dhe kursimoreve të cilat kanë leje të themelimit dhe funksionimit të lëshuar nga Banka Popullore.

#### **II. BAZË PËR LLOGARITJEN E REZERVËS SË DETYRUAR**

2. Bazën e llogaritjes së rezervës së detyruar (në tekstin e mëtejshëm: Bazë e rezervës së detyruar) e përbëjnë detyrimet e bankave në valutë vendase, në valutë vendase me klausolë valutore dhe në valutë të huaj (shtojca nr. 1 dhe shtojca nr. 2, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi) dhe detyrimet e kursimoreve në valutë vendase dhe në valutë vendase me klausolë valutore (shtojca nr. 1) dhe atë:

- depozitat dhe kreditë e pranuar;
- letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga bankat dhe kursimoret;
- detyrimet tjera.

Në bazën e rezervës së detyruar nuk përfshihen:

- detyrimet ndaj bankave dhe kursimoreve;
- detyrimet ndaj Bankës Popullore;
- detyrimet në bazë të instrumenteve subordinare dhe hibride të cilat, në pajtim me Metodologjinë e vërtetimit të përshtatshmërisë së kapitalit të përcaktuar nga Banka Popullore, janë pjesë nga kapitali shtesë i bankës, ose kursimores.

3. Baza e rezervës së detyruar nga detyrimet e bankave në valutë vendase nga pika 2) paragrafi (1) i këtij vendimi zvogëlohet nga vlera e shumës së kërkesës ndaj bazës së kredive të reja të personave juridik të dedikuara për financim të projekteve të ndërtimit të objekteve të reja ose rritjen e fuqisë së instaluar të objekteve ekzistuese për prodhimtari vendase të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme.

Me kredi të personave juridik, në kuptim të pikës 3) paragrafit (1) të këtij vendimi, nënkuptohen kreditë e miratuara të personave juridik, të cilët ditën e fundit të muajit kalendarik për të cilin raportohet, te banka janë të klasifikuar në kategorinë e rrezikut "A" ose "B", në pajtim me Vendimin e metodologjisë së udhëheqjes me rrezikun kreditor.

Me kredi të reja të personave juridik, në kuptim të pikës 3) paragrafit (1) të këtij vendimi, nënkuptohen kreditë e miratuara dhe të paguara pas 1 tetorit të vitit 2022 deri më 31 dhjetor 2024, të cilat kanë gjendje në ditën e fundit të muajit kalendarik për të cilin raportohet dhe të cilat i plotësojnë këto kritere:

- posedim të miratimeve dhe dokumentacionin e plotë për qëllimet e projektit, në pajtim me rregulloret dhe rregullat e Komisionit rregullator për energjetikë dhe shërbimeve të ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji i energjetikës dhe ligjeve tjera dhe rregulloreve;
- afati origjinal deri në maturim të kredisë duhet të jetë së paku dy vjet.

4. Bankat dhe kursimoret janë të obliguara ta njoftojnë Bankën Popullore për gjendjet e detyrimeve të cilat e përbëjnë bazën e rezervës së detyruar, për çdo ditë të muajit kalendarik, më së voni në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas mbarimit të muajit kalendarik për të cilin raportohet.

Bankat janë të obliguara ta njoftojnë Bankën Popullore edhe për gjendjet e detyrimeve nga pika 3) paragrafi (1) të këtij vendimi në ditën e fundit të muajit kalendarik për të cilin raportohet, më së voni në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas mbarimit të muajit kalendarik për të cilin raportohet.

Detyrimet në valutë të huaj për çdo ditë kalendarike të muajit dhe kërkesat në valutë të huaj nga pika 3) paragrafi (1) në ditën e fundit nga muaji kalendarik shprehen në denarë, me aplikim të kursit mesatar të Bankës Popullore, i cili vlen në ditën e fundit të muajit kalendarik.

Banka e kryejnë raportimin nga paragrafi (1) dhe (2) të kësaj pike përmes sistemit elektronik të Bankës Popullore të rezervës së detyruar (në tekstim e mëtejshëm: sistemi elektronik). Mënyra e përdorimit të sistemit elektronik është përshkruar në Instruksionet teknike të punës me sistemin elektronik të Bankës Popullore të rezervës së detyruar.

Kursimoret e dorëzojnë raportimin nga paragrafi (1) i këtij vendimi me postë, në formular, në pajtim me shtojcën nr. 3, si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

5. Baza e rezervës së detyruar e bankave dhe kursimoreve për një periudhë të caktuar të mbajtjes llogaritet si mesatare nga detyrimet për çdo ditë të muajit kalendarik që i paraprin dy muajve të fundit kalendarik në të cilin fillon periudha e mbajtjes së rezervës së detyruar. Baza e detyrimeve të valutës së huaj të bankave shprehet edhe në euro, me aplikim të kursit mesatar të Bankës Popullore i cili vlen në ditën e fundit të muajit kalendarik.

Baza e rezervës së detyruar e llogaritur nga detyrimet në valutë vendase ndaj të cilës zbatohet norma e rezervës së detyruar nga pika 6) paragrafi (1) nënparagrafi (1) i këtij vendimi zvogëlohet për shumën e kërkesës nga pika 3) paragrafi (1).

### **III. NORMA E REZERVËS SË DETYRUAR**

6. Norma e rezervës së detyruar e bankave është:
- 5% e detyrimeve të valutës vendase;
  - 50% e detyrimeve të valutës vendase me klauzolë valutore;
  - 19% e detyrimeve të valutës së huaj.

Me përjashtim nga paragrafi (1) nënparagrafi (3) i kësaj pike, norma e rezervës së detyruar shënon 13% e detyrimeve ndaj jo rezidentëve - shoqërive financiare me valutë të huaj me marrëveshje me afat deri në një vjet.

Me përjashtim të paragrafit (1) dhe (2) të kësaj pike, norma e rezervës së detyruar

shënon 0% për:

- detyrimet ndaj personave fizik me valutë vendase me maturim kontraktual mbi një vit;
- detyrimet ndaj personave fizik në valutë vendase me klauzolë valutore dhe në valutë të huaj, me maturim kontraktual mbi dy vite;
- detyrimet në bazë të repo-transaksioneve në valutë vendase;
- detyrimet në bazë të letrave me vlerë të borxhit të emetuara në valutë vendase dhe afat fillestar të maturimit prej së paku dy viteve, në lartësi të vlerës nominale;
- detyrimet ndaj jo rezidentëve - shoqërive financiare me valutë vendase, me valutë vendase me klauzolë valutore dhe në valutë të huaj me maturim kontraktual mbi një vit dhe detyrimet ndaj jo rezidentëve në valutë vendase, në valutë vendase dhe me klauzolë valutore dhe në valutë të huaj, me maturim kontraktual mbi dy vite.

Në depozitat të cilët janë pjesë e detyrimeve nga paragrafi (3) nënparagrafi (1) dhe (2) i kësaj pike, zbatohet norma e rezervës së detyruar prej 0%, nëse është në pajtim me kushtet e kontraktuara:

- nuk ekziston mundësi për tërheqje të parakoheshme të depozitit nga ana e personit fizik para kalimit të afatit të kontraktuar të afatizimit; ose
- është parashikuar tërheqje e parakoheshme e depozitit para kalimit të afatit të kontraktuar të afatizimit me ndërprerjen e kontratës dhe llogaritjen e interesit me zbatim të normës së interesit e cila nuk është më e lartë se 1/4 e normës së vlefshme të interesit të depozitit, për periudhën nga data e afatizimit/riafatizimit deri në datën e tërheqjes së depozitit.

7. Norma e rezervës së detyruar e kursimoreve është 2,5%.

#### **IV. LLOGARITJA E REZERVËS SË DETYRUAR**

8. Rezerva e detyruar e bankave në denarë llogaritet si përmbledhje nga:

- shuma e fituar me zbatim të normave nga pika 6) paragrafi (1) nënparagrafi (1) dhe paragrafi (3) i këtij vendimi në bazën e detyrimeve në valutë vendase;
- shuma e fituar me zbatim të normave nga pika 6) paragrafi (1) nënparagrafi (2) dhe paragrafi (3) nënparagrafet (2) dhe (5) të këtij vendimi në bazën e detyrimeve në valutë vendase me klauzolë valutore; dhe
- 23% nga shuma e fituar me zbatim të normave nga pika 6) paragrafi (1) nënparagrafi (3) paragrafi (2) dhe paragrafi (3) nënparagrafet (2) dhe (5) të këtij vendimi në bazën e detyrimeve në valutë të huaj.

9. Rezerva e detyruar e bankave në valutë të huaj shënon 77% nga shuma e fituar me zbatim të normave nga pika 6) paragrafi (1) nënpika (3) paragrafi (2) dhe paragrafi (3) nënparagrafet (2) dhe (5) të këtij vendimi në bazën e detyrimeve në valutë të huaj.

10. Banka e konfirmon rezervën e detyruar të llogaritur përmes sistemit elektronik në afat prej 18 ditëve kalendarike pas mbarimit të muajit kalendarik për të cilin raportohet dhe i cili e përbën bazën e llogaritjes së periudhës së mbajtjes së rezervës të detyruar. Nëse banka nuk e vërteton llogaritjen në afatin e paraparë, rezerva e detyruar e përcaktuar për atë periudhë të mbajtjes është përfundimtare.

11. Rezerva e detyruar e kursimoreve llogaritet me zbatimin e normës nga pika 7 e këtij vendimi të bazës së rezervës së detyruar. Kursimorja e konfirmon rezervën e detyruar të llogaritur përmes postës në afat prej 18 ditëve kalendarike pas mbarimit të muajit kalendarik për të cilin raportohet dhe i cili e përbën bazën e llogaritjes së periudhës së mbajtjes së rezervës të detyruar.

## V. MBAJTJA E REZERVËS SË DETYRUAR

12. Banka e plotëson rezervën e detyruar në denarë nëse gjendja mesatare ditore nga fondet e llogarisë së bankës të Banka Popullore dhe fondet e bankës së llogarisë për fondin e garancisë rezervë të Shtëpisë së Kliringut Sistemet e Kliringut Ndërbankar AD Shkup për periudhën e mbajtjes është së paku e barabartë me rezervën e detyruar të llogaritur, në pajtim me pikën 8) të këtij vendimi.

Në bazë ditore, banka mund tërësisht ta përdor pjesën e rezervës së detyruar në denarë e cila plotësohet përmes llogarisë të Banka Popullore.

13. Banka e plotëson rezervën e detyruar në euro nëse:

- gjendja ditore e mjeteve të ndara të bankës në llogarinë devizore të Bankës Popullore jashtë vendit është së paku e barabartë në 90% nga rezerva e detyruar e llogaritur në euro, në pajtim me pikën 9) të këtij vendimi dhe
- gjendja mesatare ditore e mjeteve të ndara të bankës në llogarinë devizore në MIPS për periudhën e mbajtjes është së paku e barabartë në 10% nga rezerva e detyruar e llogaritur në euro, në pajtim me pikën 9) të këtij vendimi.

14. Kursimorja e plotëson rezervën e detyruar në denarë nëse gjendja ditore e mjeteve të ndara të kursimorës në llogari të posaçme të rezervës së detyruar në Bankën Popullore është së paku e barabartë me rezervën e detyruar të llogaritur, në pajtim me pikën 11) të këtij vendimi.

15. Banka Popullore i përcakton periudhat e mbajtjes së rezervës së detyruar në denarë dhe në euro, për bankat dhe kursimoret, në kalendar indikues të periudhave të mbajtjes së rezervës së detyruar për vitin aktual.

Kalendari publikohet para fillimit të vitit aktual në internet faqen e Bankës Popullore.

Banka Popullore mund të bëjë ndryshime në kalendarin indikues. Kalendari i ndryshuar indikues i periudhave të mbajtjes së rezervës së detyruar publikohet në internet faqen e Bankës Popullore para fillimit të periudhës së mbajtjes për të cilin është ndryshimi.

16. Banka Popullore nuk ka remunerim të rezervës së detyruar në denarë.

Rezervës së detyruar në euro i përcaktohet remunerim me normën më të ulët nga 0% dhe norma e interesit e depozitit të disponueshëm brenda natës të Bankës Qëndrore Europiane, e cila ka vlejtur në ditën e fundit të mbajtjes. Nëse gjendja ditore mesatare e mjeteve të ndara të bankës në pajtim me pikën 13) të këtij vendimi është më e lartë se rezerva e detyruar e vërtetuar në euro për tërë periudhën e mbajtjes, tepricës së mjeteve të ndara iu përcaktohet remunerim me normë të njëjtë me normën më të ulët nga 0% dhe normë të interesit të depozitit të disponueshëm brenda natës të Bankës Qëndrore Europiane, e cila ka vlejtur në ditën e fundit të periudhës së mbajtjes, e ulur për 0,15 p.p.

Nëse normat e përcaktuara nga paragrafi (2) të kësaj pike janë negative, bankat detyrohen ti paguajnë remunerim Bankës Popullore.

Remunerimi llogaritet me aplikimin e formulës më poshtë:

$$N = \frac{ZR (VZR) \cdot n \cdot d}{100 \cdot 360}$$

ku:

N - remunerimi i rezervës së detyruar në euro për periudhën e mbajtjes;

ZR - shuma e rezervës së detyruar e plotësuar në euro;

VZR - teprica mesatare ditore e rezervës së detyruar në euro;  
n - norma e kompensimit në nivel vjetor;  
d - numri i ditëve të periudhës së mbajtjes.

Remunerimi llogaritet në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore në ditën e fundit të periudhës së mbajtjes. Remunerimi paguhet në denarë në afat prej tetë ditëve pas kalimit të periudhës së mbajtjes.

17. Nëse Banka Popullore përcakton se rezerva e detyruar e bankës ose kursimores për një periudhë të caktuar të mbajtjes është më e ulët nga rezerva e detyruar e llogaritur në pajtim me pikat 8), 9) dhe 11) të këtij vendimi, për shkak të të dhënve të gabuara të bazës së rezervës së detyruar dhe/ose të kërkesave nga pika 3) paragrafi (1), banka ose kursimorja është e obliguar:

- të ndajë mjete shtesë në kundërvlerë të denarit të përcaktuar mbi bazën e diferencës në rezervën e detyruar të ndarë, në llogari të posaçme të Bankës Popullore në kohëzgjatje të përshtatshme të periudhës/ave të mbajtjes në të cilat është vërtetuar dallimi. Me kërkesë të bankës, kohëzgjatja e mbajtjes së mjeteve shtesë në llogari të posaçme mund të shkurtohet, me që shuma e mjeteve rritet përkatësisht, dhe
- të paguan tarifë të llogaritur në shumën totale të mjeteve shtesë për periudhat e mosplotësimit, në shumë të normës së interesit përkatës të bonove të thesarit në periudhën/at në të cilat është përcaktuar dallimi. Tarifa paguhet njëherë në ditën e parë të ndarjes së mjeteve shtesë.

## **VI. DISPOZITAT PENALE**

18. Banka Popullore llogarit dhe tarifon interes penal ligjor për mospagimin e rezervës së detyruar nga ana e bankave dhe kursimoreve:

- të bilancit të papaguar mesatar ditor për gjithë periudhën e mbajtjes së rezervës së detyruar, në pajtim me pikën 12) paragrafin (1) dhe pikën 13) paragrafin (1) nënparagrafin (2) të këtij vendimi;
- të bilancit të papaguar në fund të ditës, në pajtim me pikën 13) paragrafin (1) nënparagrafin (1) dhe pikën 14) të këtij vendimi.

Bankat dhe kursimoret janë të obliguar të paguajnë normë penale ligjore në afat prej tetë ditëve nga dita e fillimit të detyrimit.

Banka Popullore mund të merr edhe masa tjera të parashikuara me ligj, në rast të mos respektimit të dispozitave të këtij vendimi.

Dispozita nga paragrafi (1) i kësaj pike nuk aplikohet në rastet e pikës 17) të këtij vendimi.

## **VII. REZERVA E DETYRUAR GJATË NDRYSHIMEVE TË STATUSIT DHE TËRHEQJA E LEJËS SË BANKËS/KURSIMORES**

19. Banka Popullore mund të përjashtojë bankën/kursimoren nga mbajtja e rezervës së detyruar prej ditës së parë të periudhës së mbajtjes, nëse bankës/kursimores i është tërhequr leja e themelimit dhe funksionimit gjatë asaj periudhe.

20. Në rast të shkrirjes ose bashkimit të bankave gjatë periudhës së mbajtjes, rezerva e detyruar transferohet në bankën e re, ose në bankën në të cilën shkrihet. Mbajtja e rezervës së detyruar paraqet shumën e mbajtjes së rezervës së detyruar të bankave të cilat bashkohen ose shkrihen.

21. Në rast të ndarjes së bankave gjatë periudhës së mbajtjes, rezerva e detyruar transferohet në bankat e reja. Çdo bankë merr pjesë nga rezerva e detyruar që paraqet

proporcion të përshtatshëm nga baza totale e rezervës së detyruar të bankës që është ndarë. I njejtë proporcion aplikohet edhe gjatë mbajtjes së rezervës së detyruar.

22. Në rast të bashkimit të kursimoreve për formim të bankës, shkrija e kursimoreve në bankë ose shëndrimin e kursimores në bankë gjatë periudhës së mbajtjes, rezerva e detyruar e kursimores për periudhën aktuale të mbajtjes transferohet në një sasi të barabartë në bankën e re, pra në bankën në të cilën shkrihet. Rezerva e detyrueshme deri në fund të periudhës aktuale plotësohet në nivel mesatar.

## **VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

23. Baza e rezervës së detyruar nga obligimet e bankave në valutë vendase të pikës 2) paragrafit (1) të këtij vendimi zvogëlohet për shumën e kërkesës së pikës 3) paragrafit (1) të këtij vendimi, deri më 30 nëntor 2030.

24. Në ditën e fillimit të zbatimit të këtij vendimi, ndalon se vlejti Vendimi për Rezervën e Detyruar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 177/21, 83/22, 153/22, 201/22, 251/22).

25. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe do të fillojë të zbatohet nga 22 marsi 2023, me mbajtjen e rezervës së detyruar, të llogaritur nga detyrimet e janarit 2023.

**Nr. 02-1364/ 4**  
**16 janar, 2023**  
**Shkup**

**Guvernatorja**  
**dhe Kryesuesja**  
**e Këshillit të Bankës Popullore**  
**të Republikës së Maqedonisë së**  
**Veriut**  
**д-р Анита Ангеловска-Бежоска**

## **SHTOJCA nr. 1**

Lista e detyrimeve në valutë vendase dhe në valutë vendase me klauzolë valutore:

**Detyrime ndaj furnizuesëve dhe detyrime tjera**  
2249 Avanse të marra në denarë - avanse të mara për qëllime tjera

**Llogari aktuale në denarë**  
800 Shoqëri jofinanciare  
801 Shteti  
802 Institucione joprofitabile të cilat ju shërbejnë amvisërive  
8053 Shoqëri financiare - shoqëri të sigurimeve  
8054 Shoqëri financiare - fonde pensionale  
8055 Shoqëri financiare - shoqëri tjera financiare  
807 Amvisëri  
808 Jorezident  
809 Llogari të kufizuara rrjedhëse

**Depozita pa afat në denarë**  
810 Shoqëri jofinanciare

|      |                                                             |
|------|-------------------------------------------------------------|
| 811  | Shteti                                                      |
| 812  | Institucione joprofitabile të cilat ju shërbejnë amvisërive |
| 8153 | Shoqëri financiare - shoqëri të sigurimeve                  |
| 8154 | Shoqëri financiare - fonde pensionale                       |
| 8155 | Shoqëri financiare - shoqëri tjera financiare               |
| 817  | Amvisëri                                                    |
| 818  | Jorezident                                                  |
| 819  | Depozita të kufizuara pa afat                               |

#### **Depozita të afatizuara në denarë**

|      |                                                              |
|------|--------------------------------------------------------------|
| 820  | Shoqëri jofinanciare*                                        |
| 821  | Shteti*                                                      |
| 822  | Institucione joprofitabile të cilat ju shërbejnë amvisërive* |
| 8253 | Shoqëri financiare - shoqëri të sigurimeve*                  |
| 8254 | Shoqëri financiare - fonde pensionale*                       |
| 8255 | Shoqëri financiare - shoqëri tjera financiare*               |
| 827  | Amvisëri*                                                    |
| 828  | Jorezident*                                                  |

#### **Detyrime në bazë të letrave me vlerë të emetuara në denarë dhe në denarë me klauzolë valutore**

|     |                                                                       |
|-----|-----------------------------------------------------------------------|
| 830 | Letra të letrës së borxhit të emetuara në denarë                      |
| 831 | Letra të letrës së borxhit të emetuara në denarë me klauzolë valutore |

#### **Detyrime në bazë të kredive në denarë**

|      |                                                              |
|------|--------------------------------------------------------------|
| 840  | Shoqëri jofinanciare*                                        |
| 841  | Shteti*                                                      |
| 842  | Institucione joprofitabile të cilat ju shërbejnë amvisërive* |
| 8453 | Shoqëri financiare - shoqëri të sigurimeve*                  |
| 8454 | Shoqëri financiare - fonde pensionale*                       |
| 8455 | Shoqëri financiare - shoqëri tjera financiare*               |
| 848  | Jorezident*                                                  |

#### **Depozita të afatizuara dhe depozita pa afat në denarë me klauzolë valutore**

|      |                                                              |
|------|--------------------------------------------------------------|
| 860  | Shoqëri jofinanciare*                                        |
| 861  | Shteti*                                                      |
| 862  | Institucione joprofitabile të cilat ju shërbejnë amvisërive* |
| 8653 | Shoqëri financiare - shoqëri të sigurimeve*                  |
| 8654 | Shoqëri financiare - fonde pensionale*                       |
| 8655 | Shoqëri financiare - shoqëri tjera financiare*               |
| 867  | Amvisëri*                                                    |
| 868  | Jorezident*                                                  |

#### **Detyrime në bazë të kredive në denarë klauzolë valutore**

|      |                                                              |
|------|--------------------------------------------------------------|
| 870  | Shoqëri jofinanciare*                                        |
| 871  | Shteti*                                                      |
| 872  | Institucione joprofitabile të cilat ju shërbejnë amvisërive* |
| 8753 | Shoqëri financiare - shoqëri të sigurimeve*                  |
| 8754 | Shoqëri financiare - fonde pensionale*                       |
| 8755 | Shoqëri financiare - shoqëri tjera financiare*               |

878 Jorezident\*

**Lizing financiar në denarë dhe në denarë me klauzolë valutore**

880 Shoqëri jofinanciare

8853 Shoqëri financiare - shoqëri të sigurimeve

8854 Shoqëri financiare - fonde pensionale

8855 Shoqëri financiare - shoqëri tjera financiare

888 Jorezident

8890 Lizing financiar në denarë me klauzolë valutore - shoqëri jofinanciare

88953 Lizing financiar në denarë me klauzolë valutore -- shoqëri financiare - shoqëri të sigurimeve

88954 Lizing financiar në denarë me klauzolë valutore - shoqëri financiare - fonde pensionale

88955 Lizing financiar në denarë me klauzolë valutore -- shoqëri financiare - shoqëri tjera financiare

8898 Lizing financiar në denarë me klauzolë valutore - jorezident

\* Me përjashtim të llogarive të amortizimit të akumuluar

**SHTOJCA nr. 2**

Lista e detyrimeve në valutë të huaj:

**Detyrime ndaj furnizuesëve dhe detyrime tjera**

2250 Avanse të marra në valutë të huaj - avanse të marra në valutë të huaj nga bankat e huaja

2259 Avanse të marra në valutë të huaj - avanse tjera të marra në valutë të huaj

**Të dalurat e llogaritura, të ardhurat e shtyra dhe llogari të përkohshme**

295 Xhirollogari tjera

**Llogari rrjedhëse në valutë të huaj**

700 Shoqëri jofinanciare

701 Shteti

702 Institucione joprofitabile të cilat ju shërbejnë amvisërive

70511 Shoqëri financiare - banka - akreditiva të mbuluara loro dhe garancione në valutë të huaj

70512 Shoqëri financiare - banka - mbulesa në bazë të çeqeve dhe letrave të kredisë në valutë të huaj

7053 Shoqëri financiare - shoqëri të sigurimeve

7054 Shoqëri financiare - fonde pensionale  
 7055 Shoqëri financiare - shoqëri tjera financiare  
 707 Amvisëri  
 708 Jorezident  
 709 Llogari të kufizuara rrjedhëse në valutë të huaj

**Llogari speciale në valutë të huaj**

712 Llogari speciale të subjekteve juridike në valutë të huaj  
 719 Llogari speciale të personave juridik në valutë të huaj

**Depozita në valutë të huaj**

720 Shoqëri jofinanciare\*  
 721 Shteti\*  
 722 Institucione joprofitabile të cilat ju shërbejnë amvisërive\*  
 7253 Shoqëri financiare - shoqëri të sigurimeve\*  
 7254 Shoqëri financiare - fonde pensionale\*  
 7255 Shoqëri financiare - shoqëri tjera financiare\*  
 727 Amvisëri\*  
 728 Jorezident\*

**73 Detyrime në bazë të letrave me vlerë të emetuara në valutë të huaj**

**Detyrime në bazë të kredive në valutë të huaj**

7401 Rezidentë - shteti\*  
 74051 Rezidentë - Shoqëri financiare - shoqëri tjera financiare\*  
 7409 Rezidentë - sektorë tjerë\*  
 748 Jorezident\*

**Lizing financiar në valutë të huaj**

780 Shoqëri jofinanciare  
 7853 Shoqëri financiare - shoqëri të sigurimeve  
 7854 Shoqëri financiare - fonde pensionale  
 7855 Shoqëri financiare - shoqëri tjera financiare  
 788 Jorezident

\* Me përjashtim të llogarive të amortizimit të akumuluar

## SHTOJCA nr. 3

Име на штедилницата

Седиште

## ИЗВЕШТАЈ

за пресметување на задолжителна резерва на штедилниците во денари за \_\_\_\_\_ година

| Сметка | Опис | Сите датуми во месецот |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    | Вкупно | Основа за задолжителна резерва<br>(Вкупно/број на календарски денови) | Задолжителна резерва<br>(основа за задолжителна резерва*проишана стапка/100) |  |  |  |
|--------|------|------------------------|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|--------|-----------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|
|        |      | 1                      | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |
|        |      |                        |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |        |                                                                       |                                                                              |  |  |  |

Место и датум

Печат и потпис на овластено лице

\*Gjatë plotësimit të formularit shënohen vetëm gjendjet e llogarive nga shtojca 1 në të cilat kursimoret kanë evidentuar gjendjet e kontabilitetit.

